

## Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Fermos (1663 - 1746)

Gajret! prá, n't'vishtira,	Qi Prillin - e dillin
Qi hjekë per Fé t'lume,	I bân me gazmue,
Pse jeten e gzu'me	N'Parriz t'ka shenjue.
E amsheuemja ty e Mira,	

[Fishta, *Meshtari i Malsis* 1905]

Një kolegji me mundësi modeste, ku përfituan formimin e tyre për meshtari rreth 200 rishtarë, ndër të cilët thuajse gjysma erdhi prej Provincës së dikurshme Kishtare të Arbënit dhe Arqipeshkvisë së Shkupit,<sup>1</sup> që vjen me thënë një institucion me gjurmë që s' shlyhen lehtë as në historiografinë e Kishës Katolike-Romake për hapësirën jetike shqipfolëse në Ballkan: Me këtë vëzhgim paraprak nisim njëherazi shkrimin tonë kushtuar këtij kolegji, duke sendërtuar kështu dëshirën farëmirë për t'i mundësuar një ditë vendin që i takon në një ribotim të ardhshëm fatlum të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar. E theksojmë këtë detaj për t'i mëshuar fort që në fillim karakterit kryesisht enciklopedik të vetë këtij punimi, në të cilin: pas një përshkrimi sado të thukët të rrethanave kulturore e politike-fetare që nxitën dhe mundësuan hapjen e këtij kolegji, do të përqendrohemi shkurt në programin mësimor dhe jetën e përditshme në të, për t'u ndalur në fund edhe në shkaqet e pasojat që çuan drejt mbylljes së tij "të parakohshme". Në përputhje me këtë synim kryesor tonin, sikurse edhe me vetë hapësirën që mundëson Hylli ynë i Dritës për shkrime të kësaj natyre, parapëlqejmë të ilustrojmë rastet që marrim në shqyrtim kryesisht me detaje të regjistruara për ata rishtarë që vinin në kolegji nga këto dy njësi administrative kishtare që përmendëm më lart. Në funksion të po këtij qëllimi kemi përfshirë gjithashtu në fund si shtojcë të punimit edhe një listë pak a shumë të plotë me të dhënat biografike kryesore për të gjithë ata rishtarë që erdhën e mësuan në kolegji nga këto treva. Ndihmë paraprake kemi

1 Për *Provincën Kishtare të Arbënit* si njësi e dallueshme administrative në hartën ekleziastike të Vatikanit në shek. e 18-të me arqipeshkëvitë dhe dioqezat përkatëse, shih hollësisht Bardhyl Demiraj 2012 9vv., ndërsa për kufijtë gjeografikë të të ashtuquajturit Dheu i Arbënit në shek. e 17-të e të 18-të shih së fundi Bardhyl Demiraj (bot.): *Dictionarium Latino-Epiroticum* (Romæ 1635) per R. D. Franciscum Blanchum, Shkodër 2008 490-491 (= Blanchus 1635 197).

përfiturar në këtë pikë sidomos prej konsultimit të punimeve ballore të dy specialistëve të arkivave të Vatikanit: Vittorio Bartocetti (1935) dhe Carlo Verducci (1978), të cilët kanë mbledhur, krehur e sistematizuar – pas gjase në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri (?) – gjithë atë material të vëllimshëm arkivor që ruhet sot e gjithë ditën në Arkivin Historik të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë.<sup>2</sup>

## 1. Një kolegji ilirik i ri: i dyti i radhës

Për hapjen e Kolegjit Ilirik të Fermos sigloi me bulë të posaçme Papa Aleksandri i 7-të dora vetë, duke mbajtur kështu parasysh edhe këshillën fanmirë të Kardinalit Antonio Barberini, i cili drejtonte ndërkohë Kongregacionin e Shenjtë të Propaganda Fide-s (1632 – 1671) në Romë.<sup>3</sup> Emërtimi i kolegjit me atributin <ilirik> (= it. <illirico>) duhet të ketë qenë atëbotë më se i zakonshëm (kryesisht) në ligjërimitin bisedor, por që erdhi e mori me kohë atë formë zyrtare, ashtu siç e njohim edhe sot: it. <Collegio Illirico di Fermo> (= shq. *Kolegji Ilirik i Fermos*), duke e mënjanuar kështu pagëzimin e dikurshëm me emërtim zyrtar it. <Collegio Pontificio di San Pietro e Paolo di Fermo> (= shq. *Kolegji Pontifikal i Shën Pjetrit dhe i Shën Palit në Fermo*).<sup>4</sup> Viti i themelimit të tij (maj 1663) dëshmon gjithsesi paskohësi në emërtim në përjasje me adashin e vet, bash me (lat.) <Collegium Illyricum Lauretanum> (= it. <Collegio

2 Vittorio Bartocetti: Il Collegio illirico di San Pietro e Paolo di Fermo (1663 - 1746), në: “Studia Picena” 11 [1935] 133-162; Carlo Verducci: Il collegio Illirico di Fermo, në: “Atti e memorie. Nuova serie” – anno 82° (1977): Le Marche e l’Adriatico Orientale: economia, società, cultura – dal XIII Secolo al primo Ottocento. Atti del Convegno Senigallia, 10-11 gennaio 1976, Ancona 1978, f. 175-196. Në këtë pikë të bën çudi fakti që nuk citon në asnjë rast punimin solid të botuar plot 42 vjet më parë prej Bartocetti-t.

Ndër autorë të tjerë që janë marrë intensivisht me problematikën, që ngërthen edhe aktivitetin e këtij kolegji, mund të përmendim edhe disa punime radhazi të Mario Moroni-t: I collegi illirici delle Marche e la penisola Balcanica in età moderna, në: “Adriatico – un mare di storia, arte, cultura; Atti del Convegno 20-22 maggio 1999 Ancona”, vol. I (a cura di B. Cleri), Ripatransone 2001, f. 183-202; si edhe: Le Marche e la penisola balcanica tra economia e cultura, në: “Munus amicitiae” (a cura G. Paci, M. L. Polichetti e M. Sensi), Loreto 2001, f. 207-210; si edhe kapitujt V: Il Collegio ilirico e la Penisola Balcanica (f. 129- 138) dhe VI: Il Collegio ilirico e l’Albania, në botimin e tij: “Tra le due sponde dell’Adriatico. Rapporti economici, culturali e devozionali in età moderna” Napoli 2010.

Të dhënat arkivore që citojnë këta autorë në punimet e tyre u përjasën në shumësinë e tyre me materialin origjinal të depozituar ndërkohë në Arkivin Historik të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s në Romë (mars 2015). Rëndësi të veçantë mëtojnë blenjtë: SOCG [= Scritture Originali riferite nelle Congregazioni Generali] vol. 371: Collegio Illirico di Fermo; dhe SC [= Scritture riferite nei Congressi] vol. 19-22: Collegi di Fermo.

3 Shih Bartocetti 1935 134.

4 Të dy shënjesit janë përfshirë në titullin e punimit të V. Bartocetti-t: Collegio Illirico di San Pietro e Paolo di Fermo (shih shën. 2). Në literaturën shkencore dhe në materialet arkivore nuk mungon as emërtimi jozyrtar, si Kolegji i Propaganda (Fide-s) (= it. <Collegio di Propaganda (Fide)->).

Illirico di Loreto>, shq. *Kolegji Ilirik i Loretos*), i cili fiton përparësi ndaj tonit edhe pse ishte pagëzuar me këtë atribut qysh në zanafillë të vet (1580-1798) nga Papa i atëhershëm, Grigori i 8-të.<sup>5</sup> Vetë emërtimi lat. <illyricum> : it. <illirico> : shq. *ilirik* si formim mbiemëror prej toponimit diturak <Illyria> – me të cilin shënjuheshin atë kohë trevat dhe vendbanimet së bashku me popullsitë (kryesisht sllave) që shtriheshin e shtrihen përgjatë e përtej brigjeve lindore të Adriatikut –, përcjell më së miri edhe thelbin e misionit kryesor si të njërit ashtu edhe të tjetrit kolegji. Bëjmë fjalë këtu për formimin meshtarak-intelektual të barinjve të rinj shpirtërorë që vinin nga treva të tilla lindore si: Dalmacia, Serbia, Arbëni (= it. <Albania>), Maqedonia, Bosnja, Bullgaria etj., dhe që pas shkollimit së bashku me shugurimin përkatës duhej të ktheheshin me misionuar dhe përkujdesur grigjën katolike në trevat e vendlindjes, të cilat ishin ngërthyer ndërkohë thujse tërësisht në suazën e Perandorisë Osmane. Ishte një ndërmarrje kjo, që vlerësohej nga vetë Kongregacioni i Shenjtë i Propaganda Fide-s: “come unico rimedio per riparare alla perdita che giornalmente si va facendo dei Cattolici che sono in quelle provincie per la sola mancanza de’ sacerdoti che loro amministrano i sacramenti, de’ quali per detta causa erano del tutto privi.”

Parë nga kjo perspektivë hapja e një kolegji të dytë, të poashtuquajtur <illirico> e po pranë brigjeve verilindore të Italisë tingëllon disi e pazakonshme, andaj kërkon edhe shpjegimin përkatës.

### 1.1 Përzgjedhja e Fermos: një domosdoshmëri e rastit

Fermo nuk ishte projektuar aspak në zanafillë si vendi ku do të hapej kolegji. Piketimi ishte bërë së pari në brigjet lindore të Adriatikut, bash në Raguzë (= sot Dubrovnik) si njëri ndër të pakët qytet-porte të mbetur nën protektoratin venedikas në bregun lindor të Adriatikut, të cilët mëtonin si të tillë autonominë e vet ndaj Portës së Lartë.<sup>6</sup> Ishte pikërisht ky pozicion i veçantë gjeostrategjik i qytetit, përkatësisht droja gjithherë e pranishme se mos ndoshta me atë hap “të pamenduar mirë” zgjohej dashur pa dashur zemërat e Zotave aktualë të Ballkanit, shi ajo e osmanllinjve, çka bëri që ipeshkvi i atëhershëm i Raguzës të hante turpin me bukë, domethënë të tërhiqte, si të thuash në kohën e duhur, pëlqimin e dhënë dikur po prej tij për të hapur këtë kolegji në bashtinë të vet.

Ndërsa kjo tërheqje disi e vonuar mund të konsiderohet – në rastin

5 Shih ndër të tjerë Slavko Kovačić: *Il collegio illirico presso il santuario della Santa Casa di Loreto 1580-1798*, në: “Atti del Convegno Pellegrini e Pellegrinaggi a Loreto nei secoli XV-XVIII”, Loreto 8-10 novembre 2001, f. 220 vv. Autori i këtyre radhëve po përgatit ndërkohë një punim të posaçëm për Kolegjin Ilirik të Loretos dhe rolin e tij në historinë e Kishës Katolike Romane në hapësirën jetike shqipfolëse.

6 Shih Verducci 1978 175; Moroni 2001 199.

më të mirë – si marrje masash paraprake të sigurisë së lartë,<sup>7</sup> përzgjedhja e Fermos si qyteti mikpritës interpretohet në letërsinë shkencore në mënyra nga më të ndryshmet. Kështu p.sh. dikush nuk mungon të përsiasë rrethanat politike, kulturore e sociale që e bënin qytetin e Fermos gjithnjë e më joshës në ushtrimin e këtij funksioni, meqë ishte me sa duket një zonë, e cila qe përballur me kohë e ndërkohë me sukses – sidomos pas thyerjes së rezistencës skënderbejane ndaj osmanllinjve – me lëvizje migratore shtresash të ndryshme sociale ndër popujt ballkanikë, të cilat synonin të integroheshin tërësisht në jetën sociale e kulturore të zonës përreth. Këtë mendim kumton së paku Verducci (1978 176v.), i cili mëngon me përcjellë edhe jehonën që përjetoi hapja e kolegjit ilirik në Fermo që ishte sipas abatit të Perastit një <ciittà ecclesiastica a queste nostre parti molto vicina, per li essercizj di pietà, e del suo studio assai più commoda di Ragusa.> (letër më 7 gusht 1662). Gjithsesi në vendimmarrje duhet të kenë ndikuar pas gjase jo pak edhe arsye të natyrës thjesht praktike, siç ishte p.sh. krijimi i mundësive të akomodimit me qira deri diku të arsyeshme në një ndërtesë të mbetur bosh falë mbylljes së Kuvendit të Kryqit të Shenjtë në atë qytet. E një rol parësor në këtë pikë luajti padyshim Kardinal Gualtieri dora vetë, i ngarkuar ndër kohë prej Kongregacionit të Shenjtë me i dhënë udhë e dum sa më parë hapjes së këtij kolegji.<sup>8</sup>

## 1.2 Kolegji: personeli dhe misioni i tij

Themelimi i kolegjit, misioni i tij, mënyra e organizimit të punës mësimore si edhe ajo e jetës së brendshme në të janë disa pamje të hetuara relativisht mirë në letërsinë shkencore bashkëkohore.<sup>9</sup> Në të mësojmë, ndër të tjera, se kolegji u vendos në një ndërtesë me qira te familjes Azzolini, ndërmjet Kishës së Shpirtit të Shenjtë (= it. <Chiesa di Santo Spirito>) dhe Kuvendit të Etërve Filipinë të Uratorit (= it. <Padri Philipini dell' Oratorio). Qiraja e arsyeshme me jo më shumë se 50 scuda në vit u rrit pas dy dekadash, në vitin 1683 me 11 scuda të tjerë, por duke iu shtuar kolegjit me atë rast edhe një shtëpi si edhe një kantinë.<sup>10</sup> Në personelin aktiv të kolegjit bënte pjesë përpos rektorit (= it. <rettore>) si përgjegjës për programin mësimor dhe shpirtëror si edhe për mbarëvajtjen e gjithë punëve administrative-financiare në kolegji, edhe një mësues i thjeshtë (= it. <maestro>), i cili mbulonte kryesisht mësimin

7 Një tjetër motiv mund të kenë qenë edhe marrëdhëniet njerka ndërmjet Vatikanit dhe Republikës së Vendikut, ksh.: Bartocetti 1935 134.

8 Bëhet fjalë këtu për Kuvendin e vogël të Kryqit të Shenjtë (= it. <Santa Croce>), që i përkiste Urdhrit të Kanonikëve Rregulltarë, i themeluar thuhet dy shekuj më parë nga vetë Papa Innocenti i 8-të. Shih me hollësisht për këtë Moroni 2001 199.

9 Shih së fundi Moroni 2001 199v.

10 Shih Bartocetti 1935 136.

e gjuhëve latinisht (pas gjase edhe italisht), përkatësisht të doktrinës së krishterë dhe ritualit roman bash në këto gjuhë. Të dy përfitonin një rrogë vjetore me 40 scuda në vit secili. Për rregullin e brendshëm në kolegji mbartte përgjegjësinë përkatëse një administrator (= it. <prefetto>) me rrogë vjetore të përgjysmuar me 20 scuda, ndërkohë që ishin të punësuar edhe dy shërbyes (me rrogë mujore tejet modeste prej 18 xhul (= it. <giuli>), ndër të cilët njëri mbulonte punët e kuzhinës. Me këtë personel të rudhur në numër ishte bërë kalkulimi i nevojshëm për të pranuar fillimisht në kolegji jo më shumë se 12 deri 15 rishtarë e për nevojat e secilit syresh ishte caktuar një kuotë vjetore me 30 scuda, të cilat do t'i mbulonte fillimisht arka e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s. Kalkulimet e mëtejshme, se mos ndoshta një pjesë e shpenzimeve për seminaristët do të mbuloheshin në një të ardhme të afërt qoftë nga ipeshkëvitë nga vinin, qoftë me rrugë private prej familjeve përkatëse, ishin të destinuar që në fillim të dështonin, kështu që edhe parashikimi fillestar se mos numri i seminaristëve do të mund të arrinte dikur deri në 60-70 vetë rezultoi dashur pa dashur të ishte utopik.

Edhe pse i njëjtë në synimin përmbyllës Kolegji Ilirik i Fermos u syzua të mos ishte patjetër një lloj zgjatimi apo degëzimi i adashit të tij në Loreto. Kështu, ndryshe nga i pari, i cili i ishte besuar Urdhrit Jezuit, Kardinal Gualtieri parapëlqeu një lloj autonomie të tij në menaxhim, përkatësisht një varësi të drejtpërdrejtë të kolegjit ndaj Kongregacionit të Shenjtë, duke emëruar në cilësinë e rektorit “un semplice prete, di costumi accomodati a un tal istituto, ma sopra tutto di pietà e di sentimento ecclesiali.” Rektori vetë duhej të bënte kujdes jo vetëm për mbarëvajtjen e formimit të rishtarëve, por të kishte si qëllim “di rimandarli al più presto alle loro Provincie”. Në përputhje me këtë qëllim, që kushtëzohej kryekëput prej nevojave imediate që kishin ipeshkëvitë në trevat ilirike, rektori ishte përgjegjës për organizimin e një programi formues intelektual-fetar të tillë që të përfundonte për çdo rishtar në një periudhë sa më të shkurtër të mundur.<sup>11</sup>

Pikërisht në mënyrën e organizimit të programit mësimor konsistonte padyshim edhe dallimi themelor me Kolegjin Ilirik të Loretos, i njohur

---

<sup>11</sup> Rrudhja në kohë e formimit meshtarak kishte pas gjithë gjasash edhe një tjetër arsye të fortë, pikërisht: “si temeva che i giovani, uscendo dal collegio, non più lontani “da tutto quello che *aveva* diversa faccia dalle miserie de’ loro paesi”, avvrebbero potuto contrarre amicizie dannose alla loro “*retiratezza*” (Verducci 1978 178). Edhe pse nuk citohet, të njëjtën arsye mëtonte kohë më parë Bartocetti (1935 135), sipas të cilit formimi minimal i nevojshëm i rishtarëve do t’i çlironte ata prej tundimit me kërkuar ndonjë punësim më të preferuar pranë nuncëve të Vatikanit, në zyrat e Kurisë së Shenjtë a gjetkë, siç kishin dëshmuar jo rrallë ish-seminaristë të Kolegjit Urban të Propagandës. (Shembuj të tillë me rishtarë të dikurshëm shqiptarë jep edhe Budi në parathënien e vet të përkthimit shqip të “*Rituale Romanum*”, Romë 1621)

sot e gjithë ditën për programin *ratio studiorum* (= baza e formimit shkollor jezuit – B.D.), i cili parakuptonte një formim afatgjatë.<sup>12</sup> Kështu, programi mësimor në Kolegjin e Fermos u përqendrua fillimisht dashur-padashur vetëm në studimin e “gramatikës”, d.m.th. në gjuhët latinisht (dhe italisht), si edhe në lëndën e moralit, e njohur atëbotë si “*casi dei coscienza*”. Sa i përket mësimin të latinishtes, konsiderohej më se e mjaftueshme që cullakët të merrnin “*che poteva condurre all’intelligenza delle cose ecclesiastiche solamente*”, duke u përqendruar kryesisht në përvetësimin e katekizmit si edhe në njohjen e ungjijve dhe të Akteve të Kuvendit të Trentos.<sup>13</sup> Për rrjedhojë u mënjanua me vetëdije leximi i detyrueshëm i letërsisë klasike.

Mësimi i gramatikës bëhej nga mjeshtri i shkollës, ndërsa lënda e moralit prej vetë rektorit. Kjo lëndë përjetoj sipas kohës dhe rastit edhe zgjerimet përkatëse. Kështu, në varësi të njërit apo tjetrit rektor, programi u zgjerua më lëndët e filozofisë dhe të teologjisë morale, ndërsa teologjia dogmatike rezultoi të ketë hyrë së pari në vitin 1722.

Zgjerimi në vazhdimësi i programit mësimor të kolegjit solli si pasojë zgjatjen në kohë të ciklit formues të nxënësve në kolegji, çka bëri që kolegji të përjetonte shpejt përballjen kryeneçe me një reagim të dyfishtë: nga njëra anë u bë më se i ndjeshëm kundërshtimi i ipeshkvijve prej dioqezave të vendlindjes: “*perché grande è il bisogno per nostre principali derelitte chiese*”<sup>14</sup> e nga ana tjetër u nxit automatikisht një kundërshti deri diku e hapur qoftë me kolegjin adash në Loreto, ashtu edhe me atë Urban në Romë, ku merrnin formim “të kompletuar” në teologji dhe meshtari rishtarët me destinacion (po/edhe) në trevat ilirike të Ballkanit. Këtij reagimi zindjellës iu shtuan me kohë edhe një numër vështirësish në rritje për mbarëvajtjen e strukturës administrative të kolegjit,<sup>15</sup> përkatësisht prej politikës financiare të Kongregacionit të Shenjtë, të cilat e çuan këtë kolegji drejt mbylljes së tij të natyrshme në vitin 1746 (shih § 2.6).

## 2. Jeta e brendshme në kolegji

Një komunitet që ngjasonte me një familje të vogël: Kështu e përshkruan Bartoccetti (1935 136vv.) jetën e ditëve të para në kolegji me rektor Don Girolamo Evangelisti-n, me mjeshtër të gramatikës Domenico

12 Shih më hollësisht: <<https://portal.dnb.de/opac.htm?method=simpleSearch&query=4442482-6>>.

13 Shih Bartoccetti 1935 134.

14 ... “Per quel che concerneva i casi di coscienza, poi, l’arcivescovo decise che i chierici, meglio che altrove, si sarebbero trovati sotto la guida di un abile sacerdote, “che *insegnasse* i casi pratici, e non i metafisici” (Verducci 1978 178)

15 Bëjmë fjalë këtu për ambientet e kolegjit, meqë Urdhri i Murgjve Filipinë të Uratorit i bleu më pas ambientet e kolegjit. Shih Moroni 2001 199; e sidomos Bartoccetti 1935 151v.

Tranquilli-n, me administrator Don Andrea Farchia-n si edhe me dy rishtarët e parë që u regjistruan në kolegji më dt. 20 maj 1663. Vinin që të dy nga Provinca Kishtare e Arbënit: Pjetër Perlati nga dioqeza e Lezhës dhe Nikollë Vladanji nga ajo e Shkodrës. Të dy u shuguruan priftërinj pesë vjet më vonë, më 1668; madje i dyti mundi të vijonte karrierën klerikale, duke u ulur më pas në fronin ipeshkëvor të Dioqezës së Lezhës. Menjëherë pasuan ardhjet e tjera, duke bërë që jeta e komunitetit të vogël të marrë kështu formë e të hyjë shpejt në rrjedhën e vet normale, siç na e mëson edhe Kardinal Gualtieri (27.11.1670): “Nxënësit [...] studiojnë dy orë e gjysmë në mëngjes, dy orë të tjera pas drekës dhe dy orë e gjysmë në darkë. Studimi përqendrohet në latinishten dhe rregullat që mësohen përmendësh: kur aftësohen thonë gjithmonë me zë të lartë në njohjen e Ungjijve dhe të katekizmit. Latinishten e bëjnë duke u bazuar në doktrinën e krishterë, të cilën e njohin të gjithë shkëlqyeshëm, e mbi gjithçka tjetër rreth katekizmit; në të njëjtën kohë u mësohet edhe ndonjë parim i moralit. Librat që u jepen për të lexuar janë të gjithë spiritualë. [...] Përveç kësaj studiojnë katekizmin e Kuvendit të Trentos, Toledo-n, Bonacina-n, rubrikat e Mesharit, dhe ushtrohen në predikim në praninë e komilitonëve dhe të Etërve [filipinë – B.D.] të Uratorit.”

## 2.1 Një ditë e zakonshme në kolegji

Sipas Kardinal Gualtieri-t, rrjedha ditore në kolegji ishte modeluar që të përgjasonte pak a shumë me atë të Kuvendit të Etërve (Filipinë) të Uratorit, sa vijon:

“Zgjimi bëhet në orën 5 kur bie kambana e Kishës së Shpirtit të Shenjtë, që dëgjohet shumë mirë edhe pse është larg. Pasi marrin sinjalin për t’u ngritur, rishtarët kanë gjysmë ore kohë për t’u veshur dhe për të rregulluar shtratin. Pastaj çohen menjëherë për të shkuar në shkollë, aty ku ndodhet një tablo e së Lumes Virgjëreshë, para së cilës gjunjëzohen dhe, duke filluar me shenjë e kryqit, luten me zë të lartë për gjysmë ore. Pastaj lexohen në varg pesë pikat e meditimit, duke bërë pauzë në heshtje pas secilës syresh për meditim. Kur mbaron kjo gjë, thuhet himni *Eja Krijuesi* (= <Veni Creator> – B.D.) së bashku me lutje të tjera.

Lutja mbaron pasi ka kaluar dikur më pak se gjysmë ore, e pastaj zë fill mësimi, ku përcillen fillimisht përmendësh leksionet dhe rregullat e shpjeguara një ditë më parë, duke pasur për këtë një gjysmë ore në dispozicion dhe sigurisht në prani të mjeshtrit, sikurse edhe të administratorit gjatë lutjes. Pasi ka kaluar gjysmë ore, lexojnë me zë të lartë leksionet e lëndëve të shkollës e të doktrinës së krishterë dhe shpjegohet

edhe rituali: ky është parimi i shkollës. Pasi mbaron recitimi, mjeshtri kumton qartë latinisht sipas rendit të rregullave latine që ata studiojnë. Pasi mbaron lënda e latinishtes, mjeshtri u shpjegon katekizmin atyre të rendit të parë si më të aftët. Më pas, që vjen me thënë një orë para vaftit të drekës, shkojnë së bashku në meshë, dhe kur është ditë festash thonë Mattutino-n dhe lavdet e Oficios së Zojës. Kthehen më pas në banesë, duke kënduar së bashku në kor lutjet e Oficios së Zojës. Pastaj ulen në tavolinë; gjatë vaftit lexohet gjithmonë ndonjë tekst spiritual. Vafti zgjat rreth gjysmë ore. Pasi (thuhen) graciet, lahen duart e pastaj shkohet në dimër pranë vatrës, duke konsumuar aty pushimin, ndërsa në verë e kalojnë atë në kopsht me ndonjë lojë me gogla ose me peta; e kjo zgjat një orë plot. Më pas hyjnë përsëri në klasë, e meqë kanë pak kohë në fund të pushimit, thonë mësimet me zë të lartë në klasë. Mjeshtri këqyr ndërkohë hartimet e tyre dhe i korrigjon. Pastaj i vë të lexojnë mësimet në detaj. Kjo procedurë zgjat plot dy orë. Më pas dalin për të marrë pak ajër ose në kopshtin e meditacionit ose jashtë ndërtesës, duke thënë gjatë rrugës Lutjen e Mbrëmjes (= <Vespro> – B.D.) dhe atë të *Mëshirimit të Zojës* (= <Compietà della Madona> – B.D.). Kthehen më pas sërishmi drejt e në banesë duke lutur *Falemi Mri* (= <Ave Maria gratia>) dhe rihyjnë në klasë për t’u ushtruar latinisht përmendësh, duke thënë Ungjijtë, Ritualin o ndonjë libër tjetër në përputhje me aftësinë që ka secili. Ata konsumojnë me këto ushtrime një qark kohor për rreth 2 orë e gjysmë. Pastaj shkojnë për të ngrënë darkë e [...] duke lexuar gjatë darkës ndonjë tekst spiritual. Pas darkës në dimër qëndrojnë rreth një orë pranë zjarrit, ku konsumohen biseda të ndryshme me njëri-tjetrin, por gjithmonë në praninë e mjeshtrit dhe të administartorit; si edhe një gjysmë ore tjetër kalon me lexim ose komentim të ndonjë ngjarjeje që ka ndodhur gjatë ditës. Deri në orën katër e gjysmë i jepet kohë secilit për të rregulluar shtratin e për të kryer nevojat personale a diçka që i del rastësisht; pastaj në katër e gjysmë është koha për të shkuar përsëri në shkollë e për të bërë lutjet sikurse bëhet në mëngjes. Aty rreth orës pesë shkojnë në shtrat për të fjetur.”<sup>16</sup>

## 2.2 Kushte jetese: të paka apo me masë?

Në relacionet e tij, Kardinal Gualtieri na kumton hollësi të mëtejshme lidhur me kushtet e akomodimit të rishtarëve në kolegji. Në Aktet e Arkivit Historik nuk mungojnë gjithashtu edhe relacione

<sup>16</sup> Bartocetti 1935 136v. (duke cituar Kard. Gualtieri-n).



të dërguarish të posaçëm prej Kongregacionit të Shenjtë, sidomos për aso rastesh kur dikush ngrinte zërin e turfullonte lidhur me trajtimin e mangët në ushqim, apo për ndonjë mungesë në veshje, ose diçka tjetër që gjoja linte ende për të dëshiruar.<sup>17</sup> Në rast se i referohemi relacioneve të Kardinal Gualtieri-t:

“Ushqimi i tyre është bukë e verë e mirë; për ditë të enjte dhe të djelë hanë një antipastë, një pjatë supë plot, një porcion mish (= <quattronce di carne>) dhe një frutë; në mbrëmje kanë një sallatë dyshe, dhe gjellën e zakonshme me një porcion mish, herë në një mënyrë e herë në një tjetër. Ditën e mërkurë dhe të premte u jepet në mëngjes një supë me zarzavate dhe erëza, dy vezë dhe një frutë, në mbrëmje kanë sallatën e zakonshme, një vezë me pak djathë dhe një frutë. Të shtunën mbahet agjërime e në mëngjes jepen dy supa, një gjellë me peshk dhe një frutë, në darkë sallatë dhe një frutë. Në ditët e agjërimit dhe të kreshmës jepen ose fiq ose rrush të thatë (= <uva passarina>). Për Krishtlindje, Pashkë dhe Rrëshaja si edhe në festën e Shën Pjetrit vafti dyfishohet.” (shih Bartocetti f. 139v.)

Siç mësojmë edhe nga ky përkshkrim deri diku i hollësishëm nuk kemi të bëjmë patjetër me ushqim zengjinësh, gjithsesi do thëne se ky ushqim nuk ishte aspak për t’u sharë e mallkuar, në kuptimin që nuk është se dallohej për keq në përqsaje me trajtimin me ushqim që gëzonin përgjithësisht seminaristët e kolegjeve pontefikalë. Megjithatë ishte pa dyshim një trajtim, me të cilin rishtarët e Kolegjit të Fermos përballonin një aktivitet mësimor të ngarkuar e në vazhdimësi, po të mbajmë parasysh këtu që pushimet në vjeshtë për ta nuk ekzistonin ose ishin fare të shkurtra.

Sa i përket veshjes, udhëzimi ishte i tillë që personeli të përkujdesej për një veshje “*alla grossa*”, d.m.th. të mbahej parasysh patjetër “*alla povertà, con quale vivevano nelle loro patrie*” (Verducci 1978 179). Me të mbërritur në kolegji, rishtarët pajiseshin me “*veste, e mantello della saia grossa d’Asisi, la quale [...] durava assai più di quella di Gubbio, o altre simili; e calzone, e giubboni delle mezelane, che si solevano fare*

17 Zëmërata e parë shpërthen më 1671 prej ipeshkvit të Durrësit, i cili erdhi në Fermo për të vizituar të nipin, duke qenë i ngarkuar edhe nga Propaganda për të bërë një relacion lidhur me mbarëvajtjen e punëve në kolegji. Ai vjen në përfundimin se komuniteti ishte në gjendje “shumë të keqe”. Fliste për “përfitimim e pakët që kishin nxënësit dhe situatën e keqe që zotëronte në kolegji, dhe se mund të kurseheshin gjithë ato shpenzime krejt të panevojshme.” “Ia vlente – shkruan ai – të përquendrohen nxënësit në Romë në Kolegjin Urban ose në Loreto.” Në një relacion kontrolli të mëvonshëm, të bërë këtë radhë nga jezuitët (Sig. Marcantonio dhe P. Remigio) rezulton i pabazë gjithë ai bërlllog fjalësh që shkruante dikur ipeshkvi i Durrësit, sipas të cilit seminaristët ishin “malvestiti, disfatti e sparuti come tanti baroncelli, senza collare e ignoranti” si edhe “il vitto è miserabile” (Shih Bartocetti 1935 137v.) Shih në këtë paragraf edhe për ankesën me shkrim të Elia Boscovich.

quà [a Fermo – B.D.].”

Largimi për në atdhe shoqërohej sigurisht me marrjen në dorëzim të pajisjeve dhe veshjeve përkatëse për rrugë. Këtë e mësojmë nga një listë të firmosur prej një rishtari që vinte nga Dioqeza e Shkupit (famullia e Kratovës), i cili sapo kishte përfunduar studimet në kolegji dhe me sa duket kishte shfaqur pakënaqësi për ato “pak” veshje dhe pajisje që po merrte me vete për në vendlindje. Me këtë rast nuk mungon as reagimi i njëhershëm i rektorit ndaj asaj ankese, si vijon: “Shënim për të gjitha sendet dhe paratë, me të cilat pajiset D. Elia Bosković në largimin e tij: 18 xhul (= <giuli>) për rrugën me kalë deri në portin e Ancona-s. Dy këmisha, dy shami, dy palë opinga (= <scarpini>), një palë mbathje; një palë benevrekë (= <sottocalzette>); dy qafore prifti; një jelek “con ferraiolo” të gjatë e të zi, një palë këpucë, një gunë dhe një këmishëz me ngjyrë të kuqe rozë, të dyja me një palë spaleta në supe; librat e dërguar nga Roma: një mesharth i vogël, një ritual, një breviar, aktet e Koncilit (të Trentos), një katekizëm, një bibël në dhjetë vëllime. Unë Elia Boscovich i kam marrë më 6 qershor 1677.”

### 2.3 Raste të skajshme: sëmundje dhe mort

Shpenzimet shtoheshin sipas rastit edhe me trajtimin mjekësor të nevojshëm si për personelin ashtu edhe për seminaristët. Për më tepër kolegji u përfshi disa herë nga epidemi të ndryshme. E tillë ishte p.sh. pllakosja e infektit të lisë dhjetë vjet pas hapjes së kolegjit që i ra thuajse gjysmës së bashkësisë e nuk mungoi aspak të shkaktojë edhe shuarje jete, siç ishte p.sh. rasti i Simon Zejmenit (? = <Simone Zameni> I, Nr. 13) nga <Pedatra> e dioqezës së Lezhës, i cili ndërroi jetë më 29 janar 1672 në moshën 19 vjeç. Dy vjet më pas, në shkurt të vitit 1674 e shoqëroi atë në banesën e fundit Gjon Lesi (= <Giovanni Lessio>) nga Debne a Kurbinin i dioqezës së Lezhës në Provincën e Arbënit. Ishin këto ngjarje të kobshme që fiksuan edhe vdekjet e para në kolegji, siç ishte edhe rasti i dhimbshëm i plevitit me pasojë mortin e Pjetër Grontella-s nga Shkodra (12.04.1669) dhe Giovanni Milaneo-s (10.04.1669) nga Spliti.<sup>18</sup> Shumëkush ankohej këso rastesh me ajrin shëndetlig (= <aria cattiva>) të mjedisit përreth, ku padyshim nuk bënte përjashtim as vetë qyteti i Feros.<sup>19</sup>

### 2.4 Shtojcë rastesh të skajshme: dënime, dëbime dhe arrati

Më datë 28 qershor 1668 “u dëbua si i dënuar për kokëfortësi dhe mosbindje nxënësi i pestë, i pranuar i radhës, Giovanni Miroslavich nga

<sup>18</sup> Gjithsesi duke parë shifrat lexojmë se ndër 193 nxënës që hynë në kolegji 20 (d.m.th. pak më shumë se 5%) ndërruan jetë po aty.

<sup>19</sup> E tillë ishte edhe ankesa e arqipeshkvit të Tivarit më 16 korrik 1686 për ambientet e kolegjit dhe klimën aspak të shëndetshme, e cila shkaktoi sëmundje tuberkulozi. Por propozimi i tij që kolegji të kalonte në ambientet e dikurshme të Kuvendit të Santa Croce-s nuk u mor parasysh, meqë ishte larg e se seminaristët mund t’u iknin duarsh.

Dublani në Dalmaci.” Ishte ky rasti i parë ekstrem por jo i fundit në jetën thuajse njëshekullore të kolegjit. Në fakt, siç citohet vazhdimisht në relacionet e ndryshme lidhur me jetën në kolegji, të qenët përgjithësisht të pakënaqur e zëmërakë si edhe ashpërsia e karakterit ishin dy ndër tiparet që i bashkonin fillimisht pa dallim të gjithë seminaristët në kolegji. Këto shfaqje buronin pas gjase prej zakoneve dhe mënyrës së jetesës në vendlindje, mundësitë e paka të kolegjit, klima e ndryshme dhe ushqimi e jo më pak nga malli dhe shqetësimi për familjen e lënë shpesh mes rrezikut dhe varfërisë. Nuk mungojnë as raste kur ndonjë rishtar nuk ishte i prerë aspak për të studiuar. Dhe fakt është që cullakët ilirikë do të fitonin shpejt namin e të pakënaqurit dhe të kryeneçit. Ky nam nuk ishte krejt i pajustificuar, në rast se mbajmë parasysh dëbimet e rastit por jo më pak edhe përpjekjet për arrati që ndërmoi njëri apo tjetri rishtar gjatë jetës në kolegji: gjithë-gjithë nja dhjetë për secilin grup (shih në shtojcë), por që me një përllogaritje të thjeshtë sendërtojnë së bashku aty te 10% të gjithë numrit të seminaristëve që hynë dikur në kolegji.<sup>20</sup>

Pjesa më e madhe e rasteve të konfrontimit ndërmjet personelit dhe seminaristëve ndodhi kryesisht në periudhën midis viteve 1674 – 1700; dallon pra si e tillë ajo periudhë kur drejtimin e kolegjit e mori në dorë si rektor i radhës Don Angelino Angelini. Ky rektor dallohej për natyrën e tij kokëzdrukthi dhe me aftësi mësimdhënëse që linin vërtet për të dëshiruar. “Non era un Granhuomo” shkruante dikur vetë vikari i vet, edhe pse rrekej të lëvdonte personin e tij.<sup>21</sup> Në këtë periudhë feksin edhe rastet më të shumta të shthurjeve disiplinore, por edhe ankesat e bëra me shkrim nga vetë nxënësit. Po të lexosh, gjen plot qyfyre, edhe sosh se si Don Angelini përshkruhet si prepotent dhe tiran e mbi të gjitha një injorant i pandreqshëm (Bartoccetti 1935 144vv.)

## 2.5 Kthesë për mirë: një rektor i ri

Gjithsesi, kjo periudhë aspak e shkurtër shqetësimi shumëskajesh – plot 26 vjet – nuk ka aspak të përqsar me fazën e lulëzimit të mirëfilltë që përrjetoj kolegji në pjesën e dytë të gjallesës së vet, e kjo pikërisht kur drejtimi i tij iu besua Don Tiberio Paccalorci-t (1702 – 1745). Është në fakt kjo periudhë që njihet gjithashtu më mirë në vetë historikun e kolegjit, meqë letrat dhe relacionet që i janë dërguar Kongregacionit të Shenjtë prej tij janë nga fillimi deri në fund “nitide, chiare, precise, serene; e tale doveva essere il suo governo, che constitui senza dubbio il periodo più bello e luminoso del Collegio di Fermo.” (Bartoccetti 1935, 148) Ky rektor i ri sapo kishte mbushur 25 vjeç kur mori përsipër detyrën, fillimisht si prorektor e prej vitit 1704 si rektor, duke dhënë mësim

<sup>20</sup> Shih edhe listën bashkangjitur punimit.

<sup>21</sup> Shih Bartoccetti 1935 147v.

edhe në lëndët e filozofisë e të teologjisë. Ai kishte përfunduar më parë studimet e rregullta në këto fusha në Universitetin e Feros, ku fitoi në kohë rekord edhe gradën akademike “Doktor në Filozofi dhe Teologji” në atë universitet, duke punuar ndërkohë si <esaminatore sinodale dell’ Arci[vescova]do a Consolato Teologo del locale Sant’Ufficio>. Pas një viti u largua me dëshirë nga ai post, ku fitonte plot 100 skuda në vit, për t’iu kushtuar tërësisht punës në Kolegjin e Feros.

Gjatë kohës së angazhimit të tij si rektor i kolegjit nuk ndeshim të depozituar gjëkund në arkivat e Kongregacionit të Shenjtë në Romë ankesa të seminaristëve apo dënime nga ana e personelit; përkundrazi lexojmë gjithnjë letra urimi dhe falenderimi ndaj tij prej shumëkujt.<sup>22</sup> Rektori gëzonte pas gjithë gjasash edhe aftësinë për të përzgjedhur një personel të përshtatshëm. Ndër mjeshtrit që u angazhuan në kohën e tij dallohen p.sh. Don Marino Minnucci për lëndën e gramatikës, pastaj dy murgjit domenikanë Lorenz Maria Monti dhe Domenico Zauni për filozofi dhe teologji. Programi mësimor përjetoi këtë periudhë zgjerim të vazhdueshëm, sidomos pas vitit 1722, kur shtohen si lëndë mësimore edhe teologjia dogmatike, shkrimi i shenjtë etj. Këto shtesa të vazhdueshme në program bënë që kolegji, përkatësisht programi mësimor që ofrohej në të, të frekuentohej rregullisht edhe nga nxënës të rinj shekullarë të familjeve qytetare të Feros.

## 2.6 Prolog: shkëlqim i brishtë

Tingëllon në fakt një lloj si mjaft rasa që përjetojmë sot e gjithë ditën në kohët moderne, kur një institucion i formimit shkollor-universitar (albanologjik) është i destinuar të mbyllet, pavarësisht suksesit apo treguesve pozitivë që bashkëbart programi i vet. Arsyeja e parë në dukje, por aspak rastësisht, duhet të ketë qenë ajo ekonomike: vënia në shitje, përkatësisht blerja e ndërtesës së familjes Azzolini – dhënë kolegjit deri atë kohë me qira –, prej Kuvendit të Etrve Filipinë të Uratorit, të cilit pas gjase i ishte rënduar ndërkohë arka e thesarit. Në fakt nuk mungoi as përpjekja e rektorit Paccalorci pranë Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s për ta blerë atë ndërtesë, meqë urdhri i murgjve filipinë ofronte për të jo më shumë se 3150 scuda. Ndonjë tjetër ndërtesë që erdhi atëbotë në konsideratë shkante aty te 4200 scuda.

Vetë kryesia e Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s nuk mungoi t’i përkushtojë këtij problemi madhor në njërin ndër

<sup>22</sup> Nën regjinë e tij për gjatë gjithë kësaj periudhe gjithçka rrjedh thajse si në vaj, edhe pse nuk mungojnë raste morti apo arratie të ndonjë seminaristi, raste këto gjithsesi të rralla, të përftuara si rezultat i përbërjes heterogjene të seminaristëve. Vdekjet nuk mund t’i atribuohen patjetër kushteve modeste në kolegji, sepse rektori nuk hezitonte t’i çonte të sëmurët edhe në banja kurative.

mbledhjet e radhës, bash më 24 janar 1746, kur pasi shoshiti te gjitha përlloraritjet e mundshme, erdhi në përfundimin se po te silleshin seminaristët e mbetur të Feros në Romë në Kolegjin Urban, do të mund të kurseheshin jo më pak se 358 scuda në vit. Kjo përlloraritje u përsiat pas gjase si shkas më se i mjaftueshëm në mënyrë që përgjigja e Etërve Kardinalë të Kongregacionit të Shenjtë të tingëllonte si vijon (?): “Supplicandum SS.mo pro facultate uniendi collegium Illyricum Civitatis Firmanae ad Collegium Urbanum de Propaganda Fide”. Papa Benedikti i 14-të në audiencën e dhënë kard. Petra më dt. 28. janar 1746 miratoi: “benigne approbare dignatus est unionem faciendam Collegii Illyrici Firmani ad Col. Urb.”.

### 3. Epilog: fund i trishtë

Kumti mortor duhet të ketë mbërritur në Fermo “si një rrufe në qiell të kthjellët.” Klithmën e parë e lëshoi Imz. Alesandro Borgia di Velletri, i cili gëzonte atëbotë postin e arqipeshkvit të Feros (1725-1764). Mëtohet shprehimisht në dokumentacionin arkivor se ai u prek thellë nga ky akt i Propagandës, edhe pse mund të mos ketë ndërmarrë ndonjë hap konkret për ta shpëtuar atë kolegj, ndoshta edhe i bindur për mosdobi të tij financiare.<sup>23</sup>

Ndërkohë rektori Paccalorci nxiton t’i shkruajë një ditë sa të brishtë aq edhe të trishtë, bash më 29 shkurt 1746, një letër të fundit kardinalit Administrator të Propagandës “Non so esprimere all V. S. Ill.ma il *dispiacere universale di tutta questa città* e l’agitazione somma in cui io mi trovo nella mia vecchiezza per la perdita di questo Collegio oltremodo da me amato e da tutti risguardato con specialissima affezione.”

Dhjetë rishtarët e fundit ishin larguar një javë më parë, qysh më 23 shkurt, në “Giorno delle Ceneri”, duke marrë bashkë me rrobat e trupit edhe 5 kaleshë (= it. <calessi>) në xhëp. Ndër ta bash pesë rishtarë shqiptarë: Zef Lumbeshi, Ndue Lumbeshi, Zef Berisha, Mati Mazreku prej Zymit, Gjakovës dhe Janjevës (Dioqeza e Shkupit), si edhe Gjon Logoreci e Gjergj Junku prej Ipeshkvisë së Shkodrës dhe Tivarit. Në fakt duhej të kishin marrë udhën drejt Romës katër ditë më parë, por s’kishin mundur për arsye të motit të keq. Vetë rektori i ngratë e kish shkruar me kohë letrën shoqëruese:

“Colle lacrime agli occhi nella mia età avanzata (69 anni), con dispiacere tale dell’animo mio, che maggiore non ricordo di averne patito in tutto il tempo nella mia vita, mi disunisco da questi figlioli a me tanto cari ed amati, ardisco dire con un amore niente minore a quello dei loro propri genitori. Sia sempre lodato e ringraziato il Signore Iddio a cui è piaciuto

<sup>23</sup> Bartocetti 1935 151v.; ndryshe Verducci 1978 182v.

disporre le cose così, in pena ben dovuta a' miei peccati."

(19.2.1746)

Rektor Paccalorci likuidoi më pas të gjitha llogaritë e lëna hapur dhe u tërhoq në vendlindjen e vet, në Civitanova, ku gëzoi një pension vjetor prej 50 skudash në vit. Ndërroi jetë aty nja dhjetë vjet më vonë, më 17 shtator 1755 në moshën 78 vjeç, ku gjeti prehje në varrezën e Kishës së Shën Françeskut (Bartocetti 1935 152). Me të – thuhet se – u shua edhe kujtesa bashkëkohore për Kolegjin Ilirik të Shën Pjetrit dhe të Shën Palit në Fermo, i cili me gjallesën e vet sado modeste la gjurmë të thella në historinë kulturore të qytetit dhe në atë të Kishës Katolike-Romane në trevat ilirike të përtej detit; në Arealin Kulturor të Veriut Katolik Shqiptar po se po.

\*  
\*   \*  
\*

Ndjek në shtojcë lista e përzgjedhur e seminaristëve të Provincës Kishtare të Arbënisë si edhe të Arqipeshkvive të Tivarit dhe të Shkupit, të pranuar në Kolegj. Lista e plotë e emrave për të gjithë seminaristët shoqëron të dyja punimet e cituara qysh në hyrje të këtij punimi (Bartocetti 1935; Verducci 1935) dhe është hartuar pas gjase më parë prej rektorit të fundit të seminarit, Paccalorci-t dora vetë. Gjithsesi ajo nuk mëton të jetë patjetër e përfunduar në kohën kur u shkrua, sidomos në fund, me ata seminaristë që vazhduan studimet në Romë. Ata seminaristë që bënë karrierë episkopale janë regjistruar veç në fund të listës, pra në një listë të veçantë. Gjithsesi numri 10 i ipeshkvijve të kësaj liste është domethënës. Në të dyja listat lexuesi i zellshëm dhe i interesuar do të marrë informacion mbi emrat e seminaristëve, destinacionin i tyre në përfundim të studimeve, apo vdekjen e parakohshme; do të mësojë edhe ndonjë detaj për do ngjarje të ndryshme, formimin në kolegj, meshat e para te celebruara, arratitë, dënimet, sëmundjet, vdekjet etj. etj., në fund të fundit gjithçka nga pak.

## Shtojcë:

### **Lista e nxënësve të Kolegjit (Ilirik) të Shën Pjetrit dhe Shën Palit në Fermo<sup>24</sup>**

(të ardhur nga dioqezat e provincës kishtare të Arbënit, si edhe të Dioqezës së Shkupit dhe të Serbisë)

1. <Pietro Perlatti> (= *Pjetër Perlati*) nga Lezha: hyri në kolegj më dt.

<sup>24</sup> Si shënim redaksional shtojmë që të gjithë emrat e rishtarëve si edhe shumë emra vendesh janë vendosur në listën tonë në kllapa majoshe (= <...>), duke i mbetur kështu besnikë regjistrimit zanafillës, përkatësisht duke mos qenë të sigurt, sa i përket vërtetësisë së tingël-limit shqip të llagapit familjar (apo emrit të famullisë), të regjistruar si të tillë në dokumentacionin e Arkivit Historik të Propagandës.

- 20.5.1633 dhe u largua më dt. 21.11.1668; më pas punoi si famullitar në po atë dioqezë.
2. <Pietro Grontella><sup>†</sup> nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 22.12.1663 dhe vdiq po aty prej pleuritit më dt. 12.4.1669. U varros në famullinë e S. Matteo-s.
  3. <Giovanni Zinigliovich> prej <Montenovo>-s në Serbi: ndoqi studimet në kolegji në periudhën 30.12.1664 – 19.7.1670.
  4. <Paolo Dranci> (= *Pal Drançi*) prej Dioqezës së Shkodrës: ndoqi studimet në kolegji në periudhën 30.12.1664 – 17.6.1670; më pas punoi si famullitar në <Trumpsi> (= shq. Trush).
  5. <Pietro Scura> (= shq. *Pjetër Skurra*) prej Dioqezës së Krujës: ndoqi studimet në kolegji në periudhën 8.12.1665 – 19.6.1670; më pas punoi si famullitar në <Bubaglie> (= Bubaj).
  6. <Andrea Balisci> (= *Ndre Ballshi*) nga Kurbini: hyri në kolegji më dt. 16.12.1668; më dt. 10.10.1673 u transferua nga Propaganda e Shenjtë për të studiuar në Kolegjin Urban në Romë për aftësi dhe mbarësjellje.
  7. <Giorgio Vladagni> (= *Gjergj Vladanji*<sup>†</sup>) nga Lezha: hyri në kolegji më dt. 6.10.1669 dhe vdiq prej sëmundjes së lisë më dt. 1.3.1672. U varros në Carmine.
  8. <Basilio Zeta> (= shq. *Vlas Zeta*) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 24.1.1671 dhe u largua nga kolegji i shoqëruar prej Gian. Batt[ist] a Bertuzi, vikar apostolik i Dioqezës së Moldavisë. Punoi aty si mësues me rrogë në shkollën <Schervich>-it.
  9. <Vincenzo Bordich> nga <Tancena> e Dioqezës së Shkupit në Serbi: hyri në kolegji më dt. 24.1.1671 dhe u largua si klerik më dt. 11.11.1675.
  10. <Andrea Paolovich> nga Prokupje e Dioqezës së Shkupit në Serbi: nuk u pranua fillimisht në kolegji, meqë nuk kishte me vete rekomandimin e abatit të Perastit (Imz. A. Zmajeviq), duke u pranuar më vonë, shi më dt. 12.6.1671, pasi dorëzoi certifikatën e kërkuar. U largua si diakon më dt. 15.5.1677. Veproi si famullitar në Kratovë dhe <Trespia> dhe vdiq në <Calaslia> në vitin 1706.
  11. <Paolo Vcovich> (= *Vukoviq/ ?*) nga Shkupi: ndoqi studimet në kolegji në periudhën 11.6.1671 deri më 5.5.1675, duke i mbyllur ato si diakon.
  12. <Elia Boscovich> nga Kratova në Ipeshkëvinë e Shkupit: ndoqi studimet në kolegji në periudhën 12.6.1671 deri më 6.5.1677, duke u shuguruar prift. Vdiq në <Popovo>, ku u ther e u masakrua prej hajdukëve.
  13. <Simone Zaneni><sup>†</sup> nga <Pedatra> e Arbënit në Dioqezën e Lezhës: hyri në kolegji më dt. 14.7.1671 e vdiq prej sëmundjes së lisë më dt.

29.1.1672. U varros në famullinë e S. Matteo-s.

- 14.<Giovanni Lessio><sup>†</sup> (= shq. Gjon Lesi) nga <Debne> ose Kurbin i Arbënit në Dioqezën e <Linia>: hyri në kolegji më dt. 18.9.1671 dhe vdiq aty nga tuberkulozi më dt. 2.2.1674 në moshën 21 vjeç. U varros në famullinë e S. Matteo-s.
- 15.<Giovanni Mastreori> (= shq. Gjon Mastërkori ?) nga Pulti (? në Dioqezën e Durrësit – *regjistruar kështu* – B.D.): Hyri në kolegji më dt. 31.12.1671. U krezmua nga Imz. Giannotto Gualtieri më dt. 22.9.1674 dhe qëndroi nën dorëzaninë e Michele Cornici-t, rektor i kolegjit. U largua si nëndiakon më dt. 2.10.1676, meqë ishte shëndetlig.
- 16.<Demetrio Vrani> (= shq. Dhimitër Vrani/Urani ?) nga Pëdhana e Dioqezës së Lezhës: hyri në kolegji më dt. 25.7.1672 dhe u largua si diakon më dt. 1.7.1678.
- 17.<Antonio Pellesio> (= shq. Ndue Pelezi ?) nga Shkiezi i Arbënit në Dioqezën e Sapës.
- 18.<Stefano Crutta> (= shq. Shtjefën Kruta) nga <Cacavicchia> (= Kakarriqi ?) i Dioqezës së Lezhës; hyri në kolegji më dt. 22.12.1674 në moshën 15 vjeç dhe u dërgua në Romë për t'u specializuar në Kolegjin Urban më dt. 23.1.1679. Ky misionar lezhjan, që ishte personifikim i shumë virtyteve, u kafshua nga një qen i tërbuar dhe vdiq në atdhe të vet.
- 19.<Paolo Caraviola> nga <Boiana> (= Bregu i Bunës): hyri në kolegji më dt. 2.6.1675 dhe u largua më dt. 2.12.1679, i dëbuar nga Kongregata e Shenjtë, pasi u dënua me tre muaj izolim në qelinë e Imz. Ipeshkvit për sjellje të paturpshme në kolegji.
- 20.<Paolo Trumpsi> (= shq. Pal Trushi) nga <Boiana> (= Bregu i Bunës): hyri në kolegji më dt. 2.6.1675 dhe u largua prej tij më dt. 1.7.1678 i prekur bronkiti ose tuberkulozi, duke ndjekur kështu këshillën e mjekut dhe lejen që i dha Kongregata e Shenjtë. U kurua në vendlindje.
- 21.<Marino Messi> (= shq. Marin Mesi) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 23.6.1675 dhe u largua për në atdhe, i shuguruar prift më dt. 9.9.1680.
- 22.<Diodato Stampaneo><sup>†</sup> nga Lezha: e pruri vetë abati Stampaneo, i ungji, më dt. 9.5.1677; shkoi me të edhe në Kolegjin Urban më dt. 22.10.1681. Në Romë mori sëmundjen e tuberkulozit dhe vdiq tre vjet më pas, kur mbërriti në Padova.
- 23.<Paolo Negri> (= shq. Pal Zezaj ?) prej Dioqezës së Lezhës: hyri në kolegji më dt. 19.5.1677 dhe u largua si nëndiakon një vit më pas, më dt. 10.5.1678. Kur u kthye në atdhe u vra prej gjakësve të vet.
- 24.<Stefano Negri><sup>†</sup> (= shq. Shtjefën Zezaj ?) prej <Castel Ranese> në Dioqezën e Sapës: hyri në kolegji më dt. 26.3.1679 dhe vdiq si



- nëndiakon në kolegji prej tuberkulozit më dt. 6.4.1685 në moshën 23 vjeç. U varros në varrezën e fretërve.
- 25.<Giovanni Topia> (= shq. Gjon Topia) prej Dioqezës së Durrësit, nip i arqipeshkëvit, i lindur në vitin 1661: hyri në kolegji më 10.5.1679. U ridërgua në atdhe me urdhër të Kongregatës së Shenjtë, pasi kishte ikur dy herë nga kolegji, se nuk donte të qëndronte. U dënua me izolim e me pas, më dt. 15.7.1685, u lirua nga kolegji.
- 26.<Simone Sugurini> nga <Cuculi> (= Kukli ?) i Dioqezës së Shkodrës në Arbëni: qëndroi në kolegji në periudhën prej dt. 26.5.1681 deri më dt. 27.10.1686; mësoi e përfitoi sidomos në lëndët e gramatikës dhe të moralit. Veproi si famullitar dhe mësues në Raguzë dhe vdiq në atdhe në vitin 1714.
- 27.<Simone Tockzi o Ginni> (= shq. Simon Toksi o Gjini) nga Boboti i Dioqezës së Shkodrës: mësoi në periudhën prej dt. 25.5.1681 deri më dt. 27.10.1691) si nëndiakon. Vdiq në atdhe në vitin 1709.
- 28.Luca Brisca (= shq. Lukë Briska) nga Briska e Dioqezës së Tivarit: hyri në kolegji më dt. 25.5.1681. U largua tinëz nga kolegji më dt. 4.8.1687, më pas kumtoi me një letër nga Venecia se kishte përfunduar si një skelet i rreckosur e thujse i mbaruar prej mjerimit. Në atë gjendje u rikthye. Veproi më pas si misionar në Tivar.
- 29.<Giovanni Birigich><sup>†</sup> prej Prokupjes në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më dt. 19.8.1683. Vdiq nga tuberkulozi më dt. 6.4.1688 dhe u varros në varrezën e fretërve.
- 30.<Martino Buscialla> (= shq. Martin Bushkala ?) prej <Molovichi>-t në Dioqezën e Durrësit: hyri në kolegji më dt. 30.10.1683 dhe u largua “con poco sapere” (me formim të mangët) më dt. 23.3.1690; veproi në atdhe.
- 31.<Giorgio Rebeglia> nga Tivari: mësoi në kolegji në periudhën prej dt. 17.11.1687 deri më dt. 2.4.1695; nxënës i aftë; veproi fillimisht si misionar e më pas vikar i përgjithshëm i Dioqezës së Tivarit.
- 32.<Giorgio Giuliazzi> nga Pastroviqi në Dioqezën e Tivarit: hyri në kolegji më dt. 16.9.1689. U dënua prej rektorit më dt. 3.6. 1691 dhe me urdhër të Kongregatës së Shenjtë, sepse bënte vetëm zullume, duke vijuar të nxiste grindje ndërmjet komilitonëve. Nuk desh të pranojë gabimet dhe të vuajë dënimin. U dëbua nga kolegji më dt. 30.7.1691.
- 33.<Gianbattista Giorga><sup>†</sup> nga Tivari: erdhi në kolegji më dt. 9.12.1694 dhe vdiq prej etheve të zjarrit pas 28 ditësh më dt. 4.1.1695. U varros në varrezën e fretërve.
- 34.<Paolo Xiuppa> (= shq. Pal Zhupa) nga Lezha: mësoi në kolegji në periudhën 23.3.1695 – 6.10.1701, duke u shuguruar prift.
- 35.<Marino Radovani><sup>†</sup> (= shq. Marin Radovani) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 11.5.1696. Vdiq më dt. 8.7.1698 në moshën 17 vjeç

nga një rritje e lartë e temperaturës dhe ethe të forta. U varros në varrezën e fretërve.

- 36.<Paolo Cenci> nga <Coter> (= Kotri ?) në Dioqezën e Sapës: mësoi në kolegji në periudhën 3.6.1696 – 28.5.1704, duke u shuguruar prift.
- 37.<Nicolò Antonioli> nga Pastroviqi në Doqezën e Tivarit: zhvilloi mësimet e rregullta në periudhën 15.5.1699 – 28.5.1704.
- 38.<Pietro Sancovich> nga Tivari: mësoi në periudhën 15.7.1699 – 7.11.1706.
- 39.<Simone Negri> (= shq. Simon Zezaj ?) nga Mërquinja në Dioqezën e Lezhës: hyri në kolegji më dt. 27.6.1700 dhe u largua për në atdhe më dt. 7.11.1703 për arsye të gjendjes së rënduar shëndetësore (të mushkërive).
- 40.<Nicolò Giorga> nga <Spizza> në Dioqezën e Tivarit: mësoi me rezultate të shkëlqyera gjatë periudhës 17.7.1701 – 7.5.1708.
- 41.<Paolo Teodori> (= shq. Pal Teodori) nga Pistulli i Dioqezës së Sapës: mësoi në periudhën 13.12.1701 – 7.11.1706.
- 42.<Marino Angeli><sup>†</sup> (= shq. Marin Engjëlli) nga Shiroka në Dioqezën e Shkodrës: hyri në kolegji më dt. 13.12.1701 dhe u largua më dt. 12.11.1702 me këshillën e mjekut, meqë ishte prekur nga një sëmundje e rëndë bronkeve ose tuberkulozi. Vdiq pesë muaj më vonë në moshën 19 vjeç (më dt. 23.4.1703) në Raguzë në shtëpinë e Abat <Ricciardi>-t.
- 43.<Pietro Prodani> (= shq. Pjetër Prodani) nga Kurbini në Dioqezën e Durrësit: kreu formimin si diakon në periudhën 22.7.1702 – 30.11.1710.
- 44.<Giacomo Ioscich> nga Dioqeza e Shkupit: mësoi në kolegji në periudhën 12.10.1702 – 6.5.1706.
- 45.<Giovanni Gini> (= shq. Gjon Gjini) nga <Sciassi> (= shq. Shasi) në Dioqezën e Shkodrës: hyri në kolegji më dt. 31.3.1704 dhe mori arratinë katër muaj më vonë më dt. 2.7.1704.
46. <Giovanni Camsi> (= shq. Gjon Kamsi) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 7.7.1704, duke u transferuar më pas (më 21.10.1711) në Romë në Kolegjin Urban.
- 47.<Nicolò Summa> (= shq. Nikollë Suma) nga Sapa në Arbëni: qëndroi në kolegji në periudhën 18.7.1704 – 17.6.1715, duke u shuguruar prift. Vdiq në moshën 28 vjeç në vitin 1720.
- 48.<Pietro Summa> (= shq. Pjetër Suma) nga <Grucha> (= shq. Gryka ?) në Dioqezën e Lezhës: mësoi në kolegji me rezultate kalueshëm në periudhën 6.8.1705 – 2.11.1711.
- 49.<Petro Trasci> (= shq. Pjetër Trashi) nga Pëdhana në Dioqezën e Lezhës: mësoi në kolegji në periudhën 6.8.1705 – 21.7.1712.
- 50.<Pietro Gambari><sup>†</sup> (= shq. Pjetër Gambari) nga <Ermagni> (= shq.

- Ermaji) në Dioqezën e Shkodrës: hyri në kolegji më dt. 9.2.1702 dhe vdiq pas një operacioni në kolegji në moshën 25 vjeç, i sëmurë nga kanceri ose një tumor në këmbë. U varros në varret e fretërve.
- 51.<Nicolò Nasachi> nga Tivari: hyri në kolegji më dt. 25.4.1708 dhe u transferua më dt. 28.10.1708 në Romë në Kolegjin Urban.
- 52.<Nicolò Neri> (= shq. Nikollë Ziu/Zezaj ?) nga Kruta në Dioqezën e Sapës: mësoi në periudhën 17.5.1708 – 17.6.1715, duke u shuguruar prift.
- 53.<Giorgio Ivanovich> (= shq. Gjergj Ivanaj) nga Gjakova në mbretërinë e Serbisë: hyri në kolegji më dt. 10.7.1711. “Ia mbathi, ndërsa shihte meshë bashkë me nxënësit e tjerë në Kishën e Shpirtit të Shenjtë të Etërve Filipinë të Uraorit, më dt. 12.2.1715.”
- 54.<Marco Xiuppa> (= shq. Mark Zhupa) nga Velja në Dioqezën e Lezhës: mësoi si diakon në periudhën 2.4.1712 – 5.9.1718.
- 55.<Giorgio Logopachi> (= shq. Gjergj Logopaki) nga Kurbini në Dioqezën e Durrësit: mësoi në periudhën 4.6.1712 – 5.9.1721. Dha meshën e parë në mënyrë shembullore në kishën e S. Casa di Loretto.
- 56.<Ambrosio Mamoli> (= shq. Ambroz Momli ?) nga Biza në Dioqezën e Durrësit: kreu mësimet shkëlqyeshëm në periudhën 4.6.1712 – 15.9.1721, duke u shuguruar prift.
- 57.<Angelo Cucci> (= shq. Engjëll Kuqi) nga Jubani në Dioqezën e Shkodrës: mësoi në periudhën 15.9.1712 – 29.8.1718, duke u shuguruar prift.
- 58.<Angelo Logorezzi> (= shq. Engjëll Logoreci) nga Jubani në Dioqezën e Shkodrës: hyri në kolegji më dt. 21.12.1712, por u lirua në maj të vitit në vazhdim nga Kongregata e Shenjtë, pas një letre rekomanduese të ipeshkvit të vet.
- 59.<Antonio Murici> (= shq. Ndue Murriqi) nga Kallmeti në Dioqezën e Lezhës: kreu shkollimin si nëndiakon në periudhën 30.4.1713 – 31.8.1718.
- 60.<Giovanni Cola> (= shq. Gjon Kola) nga Gjadri në Dioqezën e Sapës. Kreu mësimet në periudhën 20.5.1713 – 15.9.1721, duke u shuguruar prift.
- 61.<Giovanni Guga> (= shq. Gjon Guga) nga Shiroka në Dioqezën e Shkodrës: mësoi në kolegji periudhën 1.4.1718 – 12.7.1727, duke u shuguruar prift me aftësi shembullore.
- 62.<Marco Calamasci> (= shq. Mark Kallamashi) nga Gjadri në Dioqezën e Sapës: qëndroi në kolegji në periudhën 15.7.1712 – 27.7.1727, duke u shuguruar prift. Gjithsesi u largua pa përfunduar plotësisht studimet, meqë ishte i dobët.
- 63.<Paolo Cambisi> (= shq. Pal Kampsi) nga <Remanji> (= shq. Ermaji) në Dioqezën e Shkodrës: kreu mësimet në periudhën 13.4.1721 –

- 24.4.1730, duke u shuguruar prift.
64. Andrea Radovani (= shq. Ndre Radovani) nga Shiroka në Dioqezën e Shkodrës: kreu studimet në periudhën 5.1.1722 – 25.7.1730, duke u shuguruar prift.
65. <Alessandro Dudi><sup>†</sup> (= shq. Llesh Dudi) nga <Bulgheri> (= shq. Bujgëri ?) në Dioqezën e Lezhës: hyri në kolegji më dt. 28.7.1722. Më dt. 19.4.1727 vdiq në moshën 20 vjeç pas katër muajsh lëngimi në shtrat prej “male etico”. U varros te varret e fretërve.
66. <Lazzaro Ghieci> (= shq. Lazër Gjeçi) nga Kurbini në Dioqezën e Durrësit: kreu studimet në kolegji në periudhën 6.10.1722 – 12.7.1733, duke u shuguruar prift. Më dt. 31 maj 1733 celebroi meshën e parë në Kishën e Etërve Filipinë “e fu dal medesimo solennemente cantata con musica e coll’ intervento di molti sinori Fermani e vi furono dispensati due mute di libretti con vari sonetti.”
67. <Michele Messico> nga <Bilagni> (= shq. Bilaj) në Dioqezën e Durrësit: kreu me sukses studimet në periudhën 31.5.1727 – 20.7.1735, duke u shuguruar prift.
68. <Filippo Debeglia> nga Tivari: kreu me sukses studimet në periudhën 27.10.1727 – 7.7.1737, duke u shuguruar prift.
69. <Rafaele Antonio Albani> nga Tivari: kreu me ndërprerje studimet në kolegji gjatë periudhës 30.11.1729 – 20.8.1743; ishte larguar pa leje nga kolegji më dt. 17.7.1730 për të shkuar në Ancona tek i ungji, kështu që u dënua me izolim për 27 ditë e më pas u dërgua në Romë. Prej andej u rikthye në Fermo më dt. 2.6.1731.
70. <Giovanni Pestani> (= shq. Gjon Peshtani) nga Briska në Dioqezën e Tivarit: hyri në kolegji më dt. 27.1.1730 e më pas (19.7.1738) u transferua në Romë në Kolegjin Urban.
71. <Antonio Logorezzi> (= shq. Ndue Logoreci) nga Jubani në Dioqezën e Shkodrës: studioi në kolegji në periudhën 2.3.1733 – 28.11.1735 e më pas u transferua në Romë në Kolegjin Urban.
72. <Andrea Delvesi> nga Gramshi në Dioqezën e Sapës: hyri në kolegji më dt. 29.10.1736 dhe u largua i sëmurë më dt. 22.5.1743.
73. <Nicola Lindi> (= shq. Nikollë Lindi) nga Blinishti në Dioqezën e Sapës: kreu studimet në periudhën 19.6.1737 – 12.12.1743, duke u larguar si nëndiakon.
74. <Nicolò Babovich><sup>†</sup> (= shq. Nikollë Baboviq) nga Shestani në Dioqezën e Tivarit: u dërgua në kolegji më dt. 7.7.1738 prej Kolegjit Urban në Romë, ku kishte qëndruar tre vjet, por më dt. 26.12.1738 vdiq në moshën 20 vjeç nga një sëmundje mushkërisht që e kishte bartur nga Roma. U varros në varret e fretërve.
75. <Stefano Kampsi><sup>†</sup> (= shq. Shtjefën Kampsi) nga Tophana, lagje në Shkodër: erdhi në kolegji më dt. 29.5.1740 e vdiq më dt. 26.11.1745

në moshën 21 vjeç në Porto di Fermo, ku u kurua kundër <etisia> (= med. ektazi ?).

- 76.<Giuseppe Lumbesci> (= shq. Zef Lumbeshi) nga <Sunfi> (= shq. Zymi ?) në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më dt. 7.8.1740 dhe u transferua në vitin 1746 në Kolegjin Urban në Romë.
- 77.<Matteo Masarek> (= shq. Mati Mazreku) nga Janjeva në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më dt. 18.9.1740 dhe u transferua më pas (13.3.1744) në Kolegjin Urban në Romë.
- 78.<Giuseppe Beriscia> (= shq. Zef Berisha) nga Gjakova në Dioqezën e Shkupit: hyri në kolegji më 18.9.1740 e kaloi më pas në vitin 1746 në Romë në Kolegjin Urban.
- 79.<Giovanni Logorezzi> (= shq. Gjon Logoreci) nga <Bria> në Dioqezën e Shkodrës: hyri në Kolegji më dt. 7.4.1742 e kaloi më pas në vitin 1746 në Romë në Kolegjin Urban.
- 80.<Marco Summa> (= shq. Mark Suma) nga <Babba> (= Babaj ?) në Dioqezën e Sapës: hyri në kolegji më dt. 7.4.1742, por u nis për në shtëpi i sëmurë më dt. 16.9.1745
- 81.<Antonio Lumbesci> (= shq. Ndue Lumbeshi) nga Dioqeza e Shkupit, i ardhur prej Kolegjit të Loretos më dt. 29.5.1744 dhe u transferua në Kolegjin Urban në vitin 1746.
- 82.<Giorgio Junchi> nga <Livari> në Dioqezën e Tivarit: hyri në kolegji më 11.12.1745 dhe u transferua në vitin 1746 në Kolegjin Urban në Romë.

### **Ipeshkvij të këtyre trevave, që kanë studiuar në Kolegjin Ilirik të Fermos.**

1. <Nicolò Vladagni> (= shq. Nikollë Vladanji) nga Shkodra: hyri në kolegji më dt. 20.5.1663 në moshën 16 vjeç dhe u largua më dt. 21.11.1668 në moshën 21 vjeç. U zgjodh më pas Ipeshkëv i Dioqezës së Lezhës. Vdiq në vitin 1712 në moshën 65 vjeç.
2. <Marco Giorga> nga Tivari: hyri në kolegji më dt. 13.12.1668 dhe u transferua më dt. 10.10.1672 në Kolegjin Urban. Më pas u konsakrua arqipeshkëv i Tivarit. Vdiq në vitin 1701.
3. <Marino Gigni> (= Marin Gjini) nga <Ticuci> (= shq. Trushi ?) në Arbëni: kreu studimet në periudhën 22.11.1669 – 21.5.1774. U zgjodh ipeshkëv fillimisht i Pultit e më pas i Sapës. Vdiq në vitin 1720 në moshën 75 vjeç.
4. <Georgio Teodori> (= shq. Gjergj Teodori) nga Pistulli në Arbëni: kreu studimet në periudhën 27.7.1670 – 11.11.1677. U zgjodh ipeshkëv i Sapës. Vdiq në vitin 1706 në moshën 62 vjeç.
5. <Antonio Babi> (= shq. Ndue Babi) nga Sapa: kreu studimet në

- periudhën 20.7.1676 – 10.8.1683. U zgjodh ipeshkëv i Shkodrës.
6. <Pietro Scura> (= shq. Pjetër Skurra) nga Biza në Dioqezën e Durrësit: kreu studimet në periudhën 9.3.1688 – 17.10.1695. U konsakrua arqipeshkëv i Durrësit. Vdiq në vitin 1738.
  7. <Giovanni Galata> (= shq. Gjon Galanta ?) nga Kurbini në Dioqezën e Durrësit: kreu studimet në periudhën 10.5.1695 – 7.11.1703. U zgjodh ipeshkëv i Sapës.
  8. <Basilio Lindi> (= shq. Vlas Lindi) nga <Lissana> (= shq. Lisna) në Dioqezën e Shkodrës: kreu studimet në periudhën 12.7.1705 – 21.7.1702. U zgjodh ipeshkëv i Lezhës e më pas i Sapës.
  9. <Michele Summa> (= shq. Mëhill Suma) nga <Babba> (= Babaj) në Dioqezën e Sapës: kreu studimet në periudhën 15.6.1711 – 31.8.1716. U konsakrua arqipeshkëv i Shkupit si “soggetto d’aspetazione”.
  10. <Giovanni Nicolovich> (= shq. Gjon P. Nikollë Kazazi) nga Gjakova në Dioqezën e Shkupit: erdhi më dt. 21.5.1720 dhe kaloi një muaj më pas në Kolegjin e Loretos. U zgjodh si vizitor apostolik i Bullgarisë dhe në vitin 1743 u konsakrua arqipeshkëv i Shkupit.

### **Abstract**

The seminary of Fermo, Italy, was most known for having prepared around two hundred Albanian seminarians from the old Province of Arbër and the Archdiocese of Shkup (present-day FYROM). The paper focuses on the activity of this seminary in the hope that in the future it will constitute a new entry in the Albanian Encyclopedic Dictionary. In fact, the essay encapsulates fundamental information to understanding the beginnings, the everyday life and the reasons that led to the closure of this educational institution, as well as the contribute it gave to the survival of the Albanian Catholic Church over the centuries of Ottoman rule. Drawing on the individual studies by Vittorio Bartocetti (1935) and Carlo Verducci (1978), two eminent researchers of Vatican archives, the present essay mainly focuses on those seminarians who came from these two constituents of the Albanian Catholic Church. A list of names and careers of these seminarians makes the present paper more complete.